VENDIM
Nr.536, datë 20.11.2006

MBI VLEFSHMËRINË E LICENCËS SË SUBJEKTIT "TV BBF"

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Ledi	Bianku	Kryetar
Mesila	Doda (Demi)	Zëvendëskryetare
Detar	Hysi	Anëtar
Frano	Kulli	Anëtar
Alban	Karapici	Anëtar

pasi mari në shqyrtim çështjen, me:

OBJEKT: Mbi vlefshmërinë e licencës së subjektit televiziv vendor "TV BBF".

BAZA LIGJORE: Neni 7 pika 21, neni 20, neni 25 dhe neni 33 i ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, pika 4.1 e rregullores "Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë RTV", si dhe vendimi nr.498, datë 17.7.2006 "Mbi shqyrtimin e dokumentacionit për rinovim licence të subjektit televiziv vendor "TV BBF",

VËREN SE:

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, me vendimin nr.29, datë 30.10.2000, ka licencuar shoqërinë "BBF" sh.a. për televizionin "BBF me nr.licence 029/TVL, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat në fushën e transmetimeve televizive analogjike tokësore, për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

Me vendimin nr.498, datë 17.7.2006 "Mbi shqyrtimin e dokumentacionit për rinovim licence të subjektit televiziv vendor "TV BBF", KKRT-ja paraprakisht vendosi të mosrinovojë licencën e subjektit "TV BBF", pasi nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit të paraqitur, rezultoi se objekti i veprimtarisë, i përcaktuar në vendimin nr.23769, datë 10.5.2000 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, binte në kundërshtim me nenin 20 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Konkretisht, objekti i veprimtarisë së shoqërisë "BBF" sh.a. është "Media vizive tv, radio, spektakle, koncerte, prodhim, shumëfishim, shpërndarje audiovidio, botim revista e gazeta".

Në mbledhjen e saj të datës 29.9.2006, KKRT-ja ra dakord që të pranojë kërkesën e subjektit "TV BBF" për shtyrjen e afatit të depozitimit të vendimit të gjykatës. Me shkresën nr.896 prot., datë 29.9.2006 KKRT-ja, krahas njoftimit për shtyrjen e afatit të depozitimit të vendimit të gjykatës, i bën me dije subjektit "TV BBF" që të depozitojë sa më shpejt të jetë e mundur dokumentacionin e kërkuar.

Depozitimi i vendimit të gjykatës konform ligjit, si kriter për rinovimin e licencës, subjektit "TV BBF" i është kërkuar edhe me shkresat nr.973/1 prot., datë 25.10.2006 dhe nr.1039/1 prot. datë 31.10.2006, por deri më tani ky vendim ende nuk është depozituar nga ky subjekt.

Nga sa më sipër, KKRT-ja konstaton se objekti i veprimtarisë së subjektit televiziv privat vendor "TV BBF" bie në kundërshtim me kërkesat e nenit 20 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, sipas të cilit objekti i veprimtarisë përcaktohet ekskluzivisht për veprimtari radiotelevizive dhe se gjatë kohës së vlefshmërisë së licencës, subjekti nuk ka qenë i rregullt në zbatimin e tij (neni 25).

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7 pika 21, nenit 25 dhe nenit 33 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores "Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë rtv", si dhe vendimit nr.498, datë 17.7.2006 "Mbi shqyrtimin e dokumentacionit për rinovim licence të subjektit televiziv vendor "TV BBF",

VENDOSI:

1. Të mos rinovojë licencën e subjektit televiziv privat vendor “TV BBF”.
2. Licenca me nr.029/TVL bëhet e pavlefshme.
3. Subjekti “TV BBF” është i detyruar të ndërpresë menjëherë transmetimin.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda një muaji në gjykatë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ledi Bianku